




Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivered	20-04-2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prllog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	1911/2021		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.106/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.106/2021 të datës 26.02.2021 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit/Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.106/2021 e datës 26.02.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 29.01.2021 për ankuesen.
- III. Detyrohet Drejtoresha e Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja Udhëheqëse e Divizionit për Integrim Evropian pranë Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 26.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 847/2021 të regjistruar me numër A.nr.106/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 02.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa me datë 11.03.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 847/2021 të regjistruar me numër A.nr.106/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti i punës për periudhën kohore Janar-Dhjetor për vitin 2020 i ankueses; Emali i datës 10.06.2020; Emali i datës 08.06.2020; Emali i datës 05.06.2020; Emali i datës 04.06.2020; Tabela për shpenzimet e skenarit baze dhe kërkesa për financim shtesa; Emali i datës 27.01.2020; Emali i datës 10.06.2020; Emali i datës 08.06.2020; Emali i datës 20.10.2020; Emali i datës 19.10.2020; Përshkrim lidhur sfidat e dala nga raporti i vendit 2020; Konkluzionet e dala nga takimi nen-komitetit “ Bujqësie dhe Peshkataria” 2020; Emali i datës 21.02.2020; Emali i datës 20.02.2020; Pasqyra financiare e donatorëve ne sektorin e bujqësisë për vitin 2014 deri me vitin 2021; Emali i datës 09.10.2020; shkrese lidhur me konferencën e mbajtur për periudhën kohore 15-16-10-2020; Emali i datës 24.11.2020; Emali i datës 28.10.2020; Emali i datës 10.08.2020; Emali i datës 03.08.2020; Përgatitja e planit te veprimit për te luftuar prerjet ilegale; Emali i datës 03.08.2020; Emali i datës 28.07.2020; Raporti mbi përpjekjet për te luftuar prerjet e drunjtëve ilegal; Emali i datës 28.07.2020; Adaptimi i draft ligjit për pyjet me rregulloret dhe direktivat e Be-se; Emali i datës 30.07.2020; Emali i datës 12.03.2020; Emali i datës 03.03.2020; Emali i datës 06.08.2020; Emali i datës 06.08.2020; Emali i datës 17.11.2020; emaili i datës 04.12.2020; Emali i datës 03.12.2020; Emali i datës 03.12.2020; Emali i datës 02.12.2020; Emali i datës 17.12.2020; Emali i datës 14.12.2020; Emali i datës 20.12.2020; Emali i datës 24.12.2020; Emali i datës 19.02.2020; Emali i datës 18.02.2020; Emali i datës 26.06.2020; Emali i datës 18.06.2020; Programi kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit 2020-2024; Emali i datës 23.10.2020; Emali i datës 21.10.2020; Emali i datës 19.10.2020; Programi kombëtar për zbatimin e marrëveshjes se stabilizim-asocimit 2020-2024; Emali i datës 20.05.2020; Plani individual vjetro i punës-2020; Emali i datës 30.12.2020; Formulari i datës 25.01.2021 për vlerësimin e rezultateve ne pune te nëpunësve civil dhe nëpunësve te shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesionale; Komentet lidhur me mospajtimin me vlerësimin vjetor te punës për vitin 2020; Formulari i datës 11.02.2021 për vlerësimin e rezultateve ne pune te nëpunësve civil dhe nëpunësve te shërbimeve Publike; Emali i datës 11.02.2021; Emali i datës 29.01.2021; Emali i datës 26.01.2021; Emali i datës 25.01.2020; Emali i datës 24.12.2020; Emali i datës 09.10.2020; Emali i datës 16.11.2020; Emali i datës 11.11.2020; Emali i datës 10.11.2020; Emali i datës 05.11.2020; Emali i datës 11.02.2021; Emali i datës 11.12.2020; shkrese e datës 14.05.2020; Emali i datës 18.05.2020; Emali i datës 18.05.2020; Emali i datës 31.03.2020; Formulari i datës 29.01.2021 për vlerësimin e rezultateve ne pune të nëpunësve civil dhe nëpunësve te shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mësimit te ulet dhe profesional; Emali i datës 25.02.2021; Emali i datës 24.02.2021; Formulari i datës 11.02.2021; Emali i datës 09.12.2020; Emali i datës 07.12.2020; Emali i datës 15.02.2021; Emali i datës 11.02.2021; Emali i datës 09.02.2021; Formulari i datës 22.02.2018 për vlerësimin e punës provuese; Formulari i datës 14.12.2018 për vlerësimin e rezultateve ne pune; Formulari i datës 19.12.2019 për vlerësimin e rezultateve ne pune; Kërkesa për përgjigje ne ankesë e datës 02.03.2021; Përgjigja ne ankesë e datës 11.03.2021;

Formulari për vlerësimin e rezultateve ne pune vitin 2018 për ankuesen; Formulari i datës 11.12.2019 i vlerësimin për vitin 2019 për ankuesen; Rishpallja e brendshme e konkursit, ne Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Shkresë drejtuar Këshilli te Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil nga Drejtoresha e drejtpërdrejt e ankueses; Kërkesa e datës 19.02.2021 me numër te protokollit 20.2021; Vendimi i datës 22.02.2021 me numër te protokollit 737/2021; Emali i datës 26.01.2021; emaili i datës 22.01.2020; Emali i datës 02.03.2020; Emali i datës 03.03.2020; Emali i datës 04.05.2020; Emali i datës 08.05.2020; Emali i datës 29.04.2020; Emali i datës 30.04.2020; Vërejtja me shkrim e datës 11.12.2020 me numër te protokollit 5058; Emali i datës 13.01.2021; Formulari i datës 23.12.2020 për vlerësimin e rezultateve ne pune për drejtoreshën e drejtpërdrejtë te ankueses; Vendimi Nr.19/2021 i datës 08.04.2021 për vazhdimin e afatit për vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit te të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit e datës 15.11.2019 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit për Integritim Evropian pranë Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Drejtoresha e Departamentit për Integritim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në cilësinë e udhëheqëses se drejtpërdrejtë, me datë 29.01.2021 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 për ankuesen me c'rast e njëjta ka konstatuar se ankuesja nuk i ka realizuar objektivat e punës si duhet sipas përshkrimit të vendit të punës dhe planit të punës, dhe ka vlerësuar ankuesen me notë të përgjithshme mjaftueshëm (2).

Ankuesja, kundër vlerësimin të rezultateve në punë për vitin 2020, me datë 26.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vlerësimi i arritjes se objektivave dhe sjelljes profesionale nuk është i drejtë dhe real, sepse e njëjta pretendon se i ka përmbush objektivat e përcaktuara dhe i ka përfunduar punët në mënyrën me të mire të mundshme dhe brenda afateve kohore. Me tutje ankuesja pretendon se vlerësimi nga udhëheqësja e drejtpërdrejtë është bërë në mënyrë tendencioze dhe në kundërshtim me Rregulloren për Vlerësimin e Rezultateve të Punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar legjislacionin në fuqi, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se deri me datë 06.10.2020, kriteret dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil kanë qenë të përcaktuara me Rregulloren Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil. Sipas kësaj rregullore, vlerësimi i rezultateve të punës bazohet në matjen e realizimit të objektivave dhe aftësive të nëpunësit civil, sipas planit individual vjetor të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës se tij. Andaj, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se vlerësimi i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses për periudhën e vlerësuar nuk ka përcaktuar objektivat, gjegjësisht nuk ka përgatitur dhe aprovuar planin individual vjetor të punës siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve

Civil. Me datë 06.10.2020 ka hyre në fuqi Rregullorja Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, dhe e njëjta me dispozitat e nenit 7 ka përcaktuar se: *Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime më nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësim të nevojshme, ndërsa mbi këtë bazë ligjore, Kolegji ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë nuk ka gjetur ndonjë dëshmi se udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses gjatë periudhës vlerësuar ka zhvilluar ndonjë takim më nëpunësen civile për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të punës për të cilat është vlerësuar, me qëllim të dhënies së sugjerimeve për përmirësim të nevojshme, kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur komunikime të vazhdueshme përmes e-mailit në mes të udhëheqëses së drejtpërdrejtë dhe ankueses lidhur me kryerjen e detyrave të punës, ku shihet se ankuesja ka kryer aktivitete të cilat lidhen drejtpërdrejtë me objektivat e punës, ndërsa gjatë këtij komunikimi nuk është vërejtur se udhëheqësja e drejtpërdrejtë ka reaguar lidhur me mos përmbushjen e ndonjë objektivi apo për shkak të jo efektivitetit në punë. Po ashtu, në formularin e vlerësimit të rezultateve të punës është cekur se vlerësimi është inkurajues për faktin se ankuesja për shkak të situatës me pandemi Covid-19, ka qëndruar në shtëpi me muaj të tërë, ndërsa me rastin e vlerësimit përfundimtar udhëheqësja e drejtpërdrejtë nuk ka marr parasysh faktin se pikërisht për shkak të situatës së krijuar me pandemi Covid-19, në vitin 2020 ka qenë e vështir përmbushja e objektivave si në vitet paraprake, sepse ankuesja nga e njëjta udhëheqëse në vitin 2018 dhe 2019 është vlerësuar me notë të përgjithshme shkëlqyeshëm (4.8).

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu gjatë administrimit të provave të lëndës ka gjetur se udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses në cilësinë e Udhëheqëses së Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, për vitin 2020 është vlerësuar me notë përfundimtare shkëlqyeshëm (4.72), që konsiderohet se e njëjta jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë të gjitha pritjet dhe nëpunësi ka kontribuar në masë të madhe në realizimin e objektivave të institucionit dhe në performancën e përgjithshme të institucionit. Andaj duke marr parasysh këtë konstatim, dhe meqenëse se realizimi i objektivave të punës të udhëheqësit të departamentit ndërlidhet me realizimin e objektivave të punës nga vartësit të tij, respektivisht udhëheqësit e divizionit, Kolegji konsideron se vlerësimi i ankueses me notë mjaftueshëm për shkak të mos përmbushjes së objektivave të punës si duhet dhe sipas planit të punës, bije në kundërtënieje me vlerësimin e rezultateve të punës të udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2020 për ankuesin dhe kthimin e lëndës në rivlerësim të udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses.

Udhëheqësja e Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, në cilësinë e udhëheqëses së drejtpërdrejtë të ankueses, me rastin e rivlerësimit obligohet që të marr parasysh të gjeturat dhe të veproje sipas pikëpamjeve juridike të dhëna në këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.106/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqëses së Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

